



Me datën: 17.03.2013
nr.03/13
Pejë

Kryesia e IRDK-së, në mbledhjen e mbajtur me datën 17.03.2013, pas një debati lidhur me gjendjen aktuale të komunitetit Egjiptian në Kosovë dhe Strategjinë e Qeverisë së Kosovë që i referohet edhe integritit të egjiptianëve të Kosovës, miraton këtë

Deklaratë

Pozita e komunitetit Egjiptian në Kosovë vazhdon të jetë jo e mirë dhe pa shenja të dukshme të përmirësimit. Komuniteti Egjiptian në Kosovë është duke mos u pajtuar me pozitën reale dhe këmbëngul që ky komunitet të jetë në pozitën e duhur. Aktualisht komuniteti Egjiptian i Kosovës është në pozitë të margjinalizuar, ashtu siç e kanë vlerësuar edhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Komuniteti egjiptian i Kosovës është pjesë e rëndësishme e shoqërisë së Kosovës dhe patjetër duhet të ketë të ardhme të përparuar në krahasim me gjendjen aktuale. Institucionet e Kosovës nuk po tregohen të përgjegjshme për përmirësimin e gjendjes aktuale të komunitetit Egjiptian në Kosovë. Qeveria e Kosovës, ka adoptuar një dokument strategjik të quajtur "Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015". Këtë dokument IRDK e ka kundërshtuar që në fillim dhe vazhdon të kundërshtoj edhe tani për arsye se ky dokument cenon identitetin etnik të Egjiptianëve të Kosovës dhe nuk pasqyron problemet dhe nevojat reale të komunitetit.

Duke qenë të këmbëngulës për përmirësimin e gjendjes reale të komunitetit Egjiptian të Kosovës, përmes kësaj deklaratë, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që menjëherë:

- Të zhvlerësoni dokumentin e quajtur "Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015".
- Të merrni masat për ngritjen e nivelit të arsimimit në të gjitha nivelet e arsimimit përmes hartimit të programeve të veçanta të subvencionimit të nxënësve dhe studenteve dhe për punësimin e të diplomuarve në nivelin superior.
- Të përcaktoni një shumë të caktuar nga buxheti i Kosovës, për çdo vit, për financimin e projekteve të infrastrukturës në vendbanimet ku është i përqendruar komuniteti egjiptian.
- Të ndërmerri masa në zbatimin e ligjit të Shërbimit Civil dhe udhëzimeve administrative që burojnë nga ky ligj, e që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal dhe qendror
- Të ndërmerri masa të veçanta, ashtu siç parashihet edhe në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të komuniteteve, për punësim në Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, FSK dhe Ndërmarrjet publike
- Të sigurohet qasje e barabartë me komunitetet tjera në mediumet publike të Kosovës

Kryetari i IRDK-së
Xhevdet Neziraj